

**STATUTI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BROS STONE GROUP” SH.P.K**

Sot, më Q3/Q4 / 2023), unë themeluesi.

1. **Stiliano Hajdari**, identifikuar me nr. personal G70510108K, lindur me 10.05.1967, në Skrapar, Shqipëri.

Kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Bros Stone Group” Sh.p.k sipas dispozitave të Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjin 9723 date 03.05.2007 ‘Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit, i ndryshuar Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor këtij Ligji dhe dispozitave vijuese te statutit si më poshtë:

KAPITULLI I

**ORTAKËT, OBJEKTI, SELIA, DHE HAPËSIRA NË INTERNET, VULA DHE
STEMA**

Neni 1: Ortak/ët e shoqërisë

1. **Stiliano Hajdari**, identifikuar me nr. personal G70510108K, lindur me 10.05.1967, në Skrapar, Shqipëri.

Neni 2: Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:

1. *Kërkim, zbulim, shfrytëzim, eksport-import e përpunim të pjesshëm të mineraleteve, sipas përcaktimit në ligjin minerar, tregëti me shumicë dhe pakicë materiale të ndërtimit, shfrytëzimit të mineraleteve, ndërtimin e hidrocentraleve dhe çdo fushë tjeter që shoqëria e gjykon si fitimprurëse, etj.*
2. *Studime dhe projekte të fushëve gjeologjike inxhinierike dhe hidrogjeologjise.*
3. *Projekte të punimeve gjeologjise e të zbulimit minerare të hapjes, përgatitjes për shfrytëzimin e mineraleteve dhe të materialeve të ndërtimit. Tregtim me shumicë e pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm.*
4. *Veprimitari në fushën e ndërtimit etj.*

Me qëllimin e vetëm për të arritur syninet e shoqërisë dhe në zbatim të kësaj të fundit, shoqëria mund të marrë interes dhe pjesëmarrje në kompani apo biznese të tjera, të kryej çdo transaksion me natyrë komerciale dhe imobiliare, financiare dhe në fushën e letrave me vlerë por këto dy të fundit jo kundrejt publikut.



Neni 3: Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj si Person Juridik dhe Fiskal në Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.
2. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së përgjithëshme sipas rregullave të parashikuara në këtë statut dhe legjislacion shqiptar në fuqi.

Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

1. Shoqëria e ka selinë ligjore të regjistruar në adresën: Rruga "Abdi Toptani", ND "Tore Drini", Kati 10, Ap.106, Tiranë
2. Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj, në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.
3. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është (nëse ka):
4. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):
5. Numër telefoni aktiv për shoqerinë 00355694857832:
6. Shoqëria ka vulën dhe stemen e saj, në të cilën është shkruar: Republika e Shqipërisë, "Bross Stone Group" sh.p.k., Vula ka formë rrëthore dhe administrohet dhe disponohet nga Administratori i shoqërisë.
7. Shoqëria ka stemën e saj të veçantë të dallueshme nga shoqëritë e tjera. Të gjitha shkresat që formulohen dhe dalin nga shoqëria duhet të nënshkruhen nga administratori dhe të vulosen me vulën e shoqërisë.

Neni 5: Personaliteti juridik:

1. Shoqeria tregtare "Bros Stone Group" sh.p.k., ka fituar personalitet juridik që nga dita e regjistrimit të saj pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar).
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mevonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.



KAPITULLI II

Kapitali dhe kuotat

Neni 6: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar.

1. Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë. (ALL)
2. Ortaku merr në pronësi kuotën e tij të kapitalit, si vijon:
3. **Stiliano Hajdari**, identifikuar me nr. personal G70510108K, lindur me 10.05.1967, në Skrapar, Shqipëri.

E barabartë me 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, si një ortak i yetëm në shoqerinë e sipër cituar;



Neni 7: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe têrheqja e kuotave të papaguara.

1. Administratori mund t'u kërkojnë ortakut/ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej, të paktën, **14 (katërmëbëdhjetë) ditësh të plota**, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kérkuar për kuotat e veta, siç përcaktohet në njoftim.
2. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirrja për pagesë.
3. Zotëruesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi bashkërisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit të cilat lidhen me këtë kuotë.
4. Nëse një thirrje për pagesë mbetet e pashlyer në fund të afatit të vet, personi të cilit i drejtohet thirrja dhe i cili është përgjegjës për pagesën, paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati deri në momentin e pagimit me një normë vjetore interesit, sipas përcaktimit te Bankës së Shqipërisë.
5. Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japi një njoftim prej jo më pak se **14 (katërmëbëdhjetë) ditësh të plota** personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi për anulim.
6. Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kérkuar nga njoftimi, mund të anulohet pas një vendimi të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut/ve. Kur ortakut/ve i anulohet têrësisht numri i kuotave që ai posidon në shoqëri, që passjell përjashtimin e ortakut/ve nga shoqëria, vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut/ve në lidhje me këtë, i paraqitet Gjykatës për shqyrtim dhe vendimmarrje lidhur me përjashtimin ose jo të ortakut/ve. Në rast të anulimit të kuotës së ortakut, kjo përfshin dhe têrheqjen e të gjithë dividendëve ose shumave të tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluara dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
7. Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e anluar mund të shitet, të rishpërndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderojnë të arsyeshme ortaku/ët e shoqërisë.
8. Personi prej të cilët janë anluar kuotat e kapitalit pushon së qënuri ortak në lidhje me kuotat e anuluara, por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e anulimit të kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara anulimit.

3

Neni 8: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet.

1. Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar (me tri të katërtat e votës) të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Nenin 87, gjithsesi e kushtëzuar nga miratimi i ortaku përkatës.
2. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 9: Çertifikatat e kuotave të kapitalit.

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave, dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72 paragrafi 2 të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në çertifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

Neni 10: Mënyrat e fitimit dhe e kalimit të kuotave.

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj;

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut dhe Akt-Themelim.

Neni 11: Kalimi i kuotave me kontratë.

1. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe vetëm me akt notarial dhe në bazë të formalitetave të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet paraprakisht ortakeve të shoqërisë.
2. Mbledhja e Ortakeve mund të mos pranojë që administratorët/i të regjistrojnë kalimin e kuotës pranë QKB-së, nëse kuota objekt i shitjes nuk shlyhet tëresisht në kapitalin e shoqërisë.
3. Nëse Mbledhja e Ortakeve nuk pranon të regjistrohet kalimi i kuotës, administratorët/i brënda 1 (një) muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë blerësit njoftimin për mospranimin.
4. Pjesë të kapitalit themeltar mund t'i transferohen tëresisht ose pjesërisht personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të Ortakeve të

4

shoqërisë, por duhet të njoftojnë me shkrim, përpara Ortakët të cilët kanë prioritet për blerien e kuotave brënda 30 (tridhjetë) ditë të plota pune.

Neni 12: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit.

1. Nëse një ortak vdes, bashkëzotëruesh e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotëruesh i vetëm ose një bashkëzotëruesh i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij. Por asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratorët/i, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës, ose të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesh vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës të ky person tjetër.
3. Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gjzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesh i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKB-së, ai nuk gjzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

Neni 13: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.


1. Mbledhja e Ortakut/ve, mund të zmadhojë kapitalin me vendim të saj, duke emërtuar kuota të reja në favor të ortakut/ve ekzistues, me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej Ortakut/ve, nëpërmjet zmadhimit të vlerës së kuotave ekzistuese. I njëjti vendim i Mbledhjes së Ortakëve kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.
2. Me anë të një vendimi të Mbledhjes së Ortakëve, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

Kapitulli III

Mbledhja e Përgjithshme e Ortakut/ve

Neni 14: Të drejtat dhe detyrimet.

1. Mbledhja e përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit dhe akt-themelimit të shoqërisë;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve/it;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët/i, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;



5

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve/it;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Mbledhja e përgjithshme **merr vendime** për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

Të gjitha vendimet e marra nga Mbledhja e Ortakeve regjistrohen në **një regjistër të vendimeve**, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) *miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*

b) *shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;*

c) *investime;*

ç) *vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.*

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Neni 15: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

1. Administratori mund të thërrasë mbledhjen e Ortakut/ve kur ta mendojë të arsyeshme vetë, dhe sa herë ta kërkojë secili Ortak në përputhje me Nenin 84 të Ligjit dhe sa herë Mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme thirret të paktën 1 (një) herë në vit sipas Nenit 82 të Ligjit.
2. Mbledhja e Ortakut/ve thirret nga administratori/ët me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike që i drejtohet ortakeve. Njoftimi duhet të bëhet të paktën **14(katërmëdhjetë) ditësh të plota pune** përpara mbledhjes. Njoftimi për mbledhjen drejtar Ortakeve, duhet të përbajë vendin, datën dhe orën e Mbledhjes si edhe Rendin e ditës.
3. Mosveprimi i paqëllimit për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhje nga Ortakët ose nga persona që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë, i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 16: Punimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Ortakeve.

1. Punimet e mbledhjes nuk mund të fillojnë nëse nuk janë të pranishëm Ortakët ose përfaqësuesi i tyre.
2. Të pranishmit në Mbledhje caktojnë si Kryetar anëtarin më të vjetër në moshë për të drejtar punimet e mbledhjes, dhe një person për të mbajtur proçesverbalin e mbledhjes. Proçesverbal i mbledhjes, i cili përbën evidentimin *prima facie* të

procédimit të mbledhjes, duhet të nënshkruhet nga kryetari i saj dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

3. Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit/ve i lejohet të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakeve.

4. Me pëlqimin e pjesëmarrësve në mbledhje, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon rregullorja), t'i shtyjë punimet e Mbledhjes, në një thirrje të dytë të saj, por në mbledhjen e shtyrë nuk mund të diskutohet asnjë pikë tjeter, me përashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht, nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e thirrjes së parë. Kur punimet e Mbledhjes janë shtyrë për 14 (katërmëdhjetë) ditësh ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën 7 (shtatë) ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të rendit të ditës që do të diskutohet.

Neni 17: Votat e ortakëve.

1. Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e ortakut, i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.
2. Secili Ortak nuk voton në mbledhje, në asnjë nga thirrjet e saj, personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.
3. Kundërshtimet e ngritura, për plotësimin e kushteve nga ana e votuesit, i bëhen në kohë.
4. Kryetarit vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 18: Hetimet e posaçme.

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm, sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë, të një dokumenti së bashku me një deklaratë notoriale, e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

Kapitulli IV
Administratorët/i

Neni 19: Emërimi i administratorëve/it.

1. Mbledhja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator/ë të shoqërisë për një afat të caktuar me të drejtë rizgjedhjeje sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimi i nënshtrohet individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet, passjell zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.
2. Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Nenin 95 paragrafi (2) të Ligjit.
3. Mbledhja e përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me vendim ne mbledhje te zakonshme te saj.
4. Shoqëria emeron si Administrator të saj të parë **Z. Fladjo Hajdari**, d.t. 07.06.1997, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me Nr. ID J80607057A për një **periudhë prej 5 (pesë) vjetësh**.



5. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bisnesit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve/it.
6. Administratorët/i e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 20: Kompetencat e Administratorëve/it.

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:
-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 21: Përgjegjësitë e Administratorit.

Veprimtaria tregtare e shoqërisë administrohet nga Administratorët/i të/i cilët/i mund t'i ushtrojnë/ë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Mbledhjes së Përgjithshme te Ortakeve. Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Mbledhjes së Përgjithshme, nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të

8

Administratorit të cilat do të kishin qenë të vlefshme, nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishte dhënë direktiva.

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
 4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit



9

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 22: Shkarkimi dhe largimi i administratorëve/it.

1. Funksioni i Administratorit lirohet nëse :
 - pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë Nenin 95 paragrafi (6).
 - vuani ose mund të vuajë nga çrrregullime mendore;
 - jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
 - ka munguar për më shumë se **6 (gjashtë muaj)** radhazi pa lejen e Mbledhjes se Ortakeve dhe Mbledhja e Përgjithshme, me propozim të Ortakeve të tjerë,
 - vendos ta shkarkojë nga detyra.
- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 23: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve/it.

1. Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
2. Administratorit i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që i lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Përgjithshme të Ortakeve si edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre, do të bëhen nga fondet e shoqërisë.

Neni 24: Proçesverbalet e mbledhjeve të Administratorëve/it.

Administratorët/i kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen proçesverbalet:

- a. e të gjithë takimeve të bëra nga Administratori; dhe
- b. të të gjitha punimeve të mbledhjeve te Ortakut/ve dhe mbledhjeve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

Neni 25: Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia.

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit, administratorët/i detyrohen/t:
 - a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mëdis;
 - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

10

- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
 - dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët/i, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standaret profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:
- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
 - b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
 - ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) japid kredi.

Kapitulli V

Dividendët dhe kapitalizimi i fitimeve

Neni 26: Dividendët.

1. Pas përbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të te Mbledhjes se Ortakeve, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtën përkatëse të secilit ortak.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat, në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët, përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtëm me shumat e paguara për kuotat, gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin sipas të cilit dividendi mund të merret duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e përfiton dividendifin sipas këtij kushti.
3. Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë, nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria, nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.
4. Nëse një dividend nuk është térhequr pas 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data kur mund të térhiqet pagesa, nëse Mbledhja e Përgjithshme vendos me

vendim, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë por ta administrojë atë në formën e miratuar në Mbledhjen e Ortakeve

Neni 27: Kapitalizimi i fitimeve.

Me autoritetin që u jep një vendim i Mbledhjes se Ortakeve, dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, Administratori/et mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë, që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferencialë ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria, nga kapitali i detyruar i shoqërisë.

Kapitulli VI

Marredheniet e Punës

Neni 28: Rregullimi i marrdhënive të punës

Marrëdhëniet e punës midis shoqërisë dhe punonjësve të saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës sipas Kodit të Punës dhe/ose marrëveshjes dypalëshe mbi punësimin.

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit e të sigurimeve shoqërore e shëndetsore për të punësuarit në të sipas legjisacionit shqiptar në fuqi.

Të punësuarit në shoqeri përgjigjen sipas ligjit dhe këtij statuti për zbatimin e detyrave dhe për dëmet e shkaktuara gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e shoqërisë dhe neë rastet kur largohen nga puna.

Kapitulli VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 29: Prishja dhe likuidimi.

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep Vendimi i Mbledhjes së Ortakut/ve dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën, ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Neni 30: Njoftimet.


1. Njoftimet që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në **Nenin 4 paragrafi (1) të këtij Statuti** që është e vlefshme në momentin dhe që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bën njoftimin.
2. Shoqëria mund t'i japë një njoftim ortakut ose personalisht ose duke ia nisur me postë në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut, ose duke ia lënë në këtë adresë, ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut.

12

3. Në këtë Statut përfshihen shtesa dhe ndryshime, dhe të gjithë dokumentet e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë që vendosen nga Administratori/ët në hapësirën në internet të shoqërisë të parashikuar në Nenin 4 paragrafi (2) të këtij Statuti.

Statuti u përpilua në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, iu lexua Ortakut me zë dhe meqënëse u gjet sipas vullnetit të tij të lirë dhe të plotë, e të pa vesuar, nënshkruhet rregullisht para kësaj shoqërie në zyrat e shoqërisë, në adresën e sipërcituar.

ORTAKË:



Stiliano HAJDARI



ADMINISTRATORË:



Fladjo HAJDARI

